



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS,
RINISË DHE SPORTEVE

Plani i Integruar i Ministrisë 2008

Shkurt 2008

Mesazhi i Ministrit



Parimi bazë i Qeverisë Shqiptare në fushën e artit dhe kulturës është mbrojtja, mbështetja dhe forcimi i identitetit kombëtar, përkundrejt sfidave të tregut dhe fenomenit të globalizimit.

Mbështetur dhe në përputhje me këtë parim, MTKRS harton, programon e zhvillon, politikat kombëtare të turizmit, kulturës, rinisë dhe sporteve në harmoni dhe koherencë të plotë me integrimin kulturor në familjen europiane.

Në përputhje me dokumentin e MSA midis Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian, MTKRS prezanton strategji dhe politika në koherencë me këtë dokument, duke zbatuar në sistemin e varësisë frymën e decentralizimit dhe të transparencës institucionale.

Hartimi dhe koordinimi i politikave nëpërmjet investimeve publike në zhvillimin e infrastrukturës së turizmit; mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, materiale e shpirtërore; krijimi i hapësirave të nevojshme për ruajtjen dhe kultivimin e kulturës së shkruar; krijimi i një mjedisi të shëndetshëm për komunitetet artistike, kulturore, rinore dhe sportive për ushtrimin e veprimtarive individuale e kolektive, të veçanta apo periodike; të gjitha këto, MTKRS i zhvillon në ndihmë të krijimit të një imazhi më të mirë të Shqipërisë dhe të integritimit sa më të shpejtë të saj në bashkësinë europiane.

MTKRS nxit dhe ndjek zbatimin e reformave të vazhdueshme institucionale në fushën që udhëheq, në funksion të përsosjes së administrimit të fondeve publike që i akordohen këtij institucioni dhe sistemit në varësi.



Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë.....	4
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë.....	5
3	Programet buxhetore të Ministrisë	7
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008	8
5	Plani i Monitorimit i Ministrisë.....	11
Aneks 1	Projekt-ligjet për tu paraqitur	12
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin European	14
Aneks 3	Investimet publike	15
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj	16
Aneks 5	Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit.....	17

1 Misioni i Ministrisë

Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MTKRS) harton, programon dhe zhvillon politikat kombëtare të turizmit, kulturës, rinisë dhe sporteve, integrimin kulturor në familjen evropiane dhe botërore, në përputhje me programin e Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

MTKRS harton dhe koordinon politikat në fushën e turizmit, nëpërmjet investimeve publike në zhvillimin e infrastrukturës, nxitjes së investimeve private, monitorimit të këtij zhvillimi, edukimit në turizëm, mbrojtjes dhe zhvillimit të potencialeve natyrore, në shërbim të turizmit, si dhe promovimit të vendit si destinacion turistik.

MTKRS harton politikat mbrojtëse dhe promovuese për trashëgiminë kulturore, materiale ose jo materiale, si dhe krijon hapësirat e nevojshme për ruajtjen e kultivimin e kulturës së shkruar, për krijimtarinë artistike në përgjithësi si dhe për rininë dhe sportet.

MTKRS harton projektligje dhe propozon ndryshime në to për fushat që mbulon, për sistemin e institucioneve në varësi të saj, si dhe ndjek zbatimin e tyre me synim reformimin e vazhdueshëm të strukturave, në funksion të përsosjes së administrimit të fondeve publike, që i akordohen këtij institucioni dhe sistemit në vartësi.

MTKRS bashkëpunon me shoqata jofitim prurëse në fushat e turizmit, kulturës, artit, rinisë dhe sporteve. Në funksion të përmbushjes së misionit, mbështet financiarisht subjekte fizikë dhe juridikë, për organizimin e aktiviteteve kulturore, artistike, për rininë dhe sportin, jep ndihmë në koordinimin e aktiviteteve dhe programeve ndërmjet subjekteve që zhvillojnë veprimtari në këto fusha, brenda Shqipërisë dhe jashtë saj, nxit dhe afron mbështetje për shkëmbime kulturore e sportive me institucione të huaja, shtete dhe subjekte të ndryshme.

MTKRS menaxhon buxhetin e caktuar vjetor, në funksion të misionit, gjithnjë me qëllim administrimin sa më të mirë dhe sa më transparent të fondeve publike, krijimin e nje mjedisi të shëndetshëm për të gjitha komunitetet artistike, kulturore, rinore dhe sportive, për ushtrimin e veprimtarive individuale dhe kolektive, të veçanta apo periodike, që të gjitha së bashku të jenë në ndihmë të lartësimit të imazhit të Shqipërisë, integritit sa më shpejtë në Europë dhe rritjen e cilësisë së jetesës prej burimeve të artit, kulturës dhe aktiviteteve sportive.

MTKRS udhëheq, programon dhe mbështet aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, me qëllim identifikimin dhe zhvillimin e tendencave kulturore, artistike, rinore dhe sportive brenda vendit, si dhe përfshirjen dhe ballafaqimin e vlerave më të mira kombëtare me ato rajonale, si ato të trashëguara dhe ato bashkëkohore.

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e turizmit

Strategjia sektoriale e turizmit 2007 - 2013, pas kryerjes së procesit të konsultimeve me grupin këshillimor i përbërë nga grupet e interesit dhe nga donatorët e huaj përkatës, si dhe pas reflektimit të komenteve të bëra nga ministrinë e linjës, është dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave.

Strategjia sektoriale e kulturës

Strategjia sektoriale e kulturës është dokumenti bazë mbi të cilin do të orientohen dhe planifikohen zhvillimet artistike dhe kulturore deri në vitin 2013. Ky dokument është hartuar nga një grup ekspertësh dhe është konsultuar në mënyrë të gjerë me grupet e interesit. Tashmë ai i është dërguar të gjitha ministrive të linjës për mendim. Parashikohet që gjatë 6-mujorit të parë strategjia do të kalojë për miratim në qeveri. Zbatimi me sukses i kësaj strategjie do të jetë një prioritet për MTKRS dhe të gjitha institucionet e varësisë duke hartuar plane konkrete veprimi të cilat do të mundësojnë ndërtimin e modeleve menaxhuese të standarteve më të larta europiane.

Strategjia sektoriale e rinisë

Strategjia Kombëtare e Rinisë është miratuar në nëntor 2006. Zbatimi i Planit Kombëtar të Veprimit të saj do të bëhet në bashkëpunim me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë që punojnë në fushën e Rinisë.

Strategjia sektoriale e sportit

Strategjia sektoriale e sportit 2007 - 2013, përmbledh politikat zhvillimore të qeverisë për reformimin e sistemit sportiv në përputhje me standartet bashkëkohore. Strategjia kombëtare e sportit është në proçes diskutimi me grupet e interesit dhe me ministrinë e linjës.

Qëllimet

- Udhëheqja dhe mbështetja e procesit të ristrukturimit të sistemit të MTKRS, në tërësi komponentët e tij të veçantë dhe në bashkëveprim të ndërsjelltë midis Turizmit, Trashëgimisë, Artit, Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në funksion të krijimit të kushteve dhe një mjedisi të favorshëm për të ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e tyre.
- Rritja e standarteve të menaxhimit dhe trajtimit të trashëgimisë shpirtërore dhe përafrimi i tyre me standartet e vendeve europiane
- Zbatimi i legjislacionit në fushën e artit dhe të kulturës për mirëmenaxhimin e institucioneve dhe subjekteve të interesuara përmes krijimit të Qendrës së Artit Skenik, sipas implementimit të ligjit "Për artin skenik" me qëllim administrimin dhe manaxhimin e fondeve si krijimtari intelektuale dhe shpirtërore që ndikon në ruajtjen dhe promovimin e identitetit kulturor kombëtar.
- Mbrojtja e pronësisë intelektuale në Shqipëri në nivel të ngjashëm me Bashkimin Europian.
- Mbështetje e artistëve, për rezultatet e niveleve të larta, duke i konsideruar si pasuri kombëtare dhe trajtimi me maksimumin e mundësive për të garantuar arritjen e vazhdueshme të cilësisë së lartë.
- Ruajtja e identitetit të kulturës shqiptare në vendet me emigracion të madh, nëpërmjet krijimit të instituteve të kulturës në ato vende.
- Zbatimin e programeve të zhvillimit që kanë për qëllim modernizimin dhe forcimin e rolit të institucioneve të ruajtjes së kujtesës në shkallë vendi.
- Synon zhvillimin e politikave rinore me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së rinjve në shoqëri e në proceset vendim-marrëse, si dhe nxit angazhimin për bashkëpunim të gjithë aktoreve

qe mbulojne zhvillimin social, kulturor dhe ekonomik te rinise duke bere te mundur krijimin e nje mjedisi të favorshem dhe te qendrueshem për integrimin social te tyre .

- Mbeshtet të rinjtë në nisma të cilat synojne integrimin dhe pjesmarrjen e te rinjve shqiptarë si një element thellesor te vizionit strategjik , per integrimin e vendit si dhe forcimin e bashkepunimit me strukturat nderkombetare.
- Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e sportit, rritja e kontributit të llotarive sportive në financimin e sportit, me synim krijimin e kushteve sa më të mira për rritjen e ushtruesve në sport dhe cilësinë sportive
- Përmirësimin e infrastrukturës sportive aktuale dhe ngritjen e një qendre sportive kombëtare, për grumbullimin e sportistëve cilësor, duke rritur cilësinë e shërbimit të ofruar dhe rritjen e cilësisë sportive nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës sportive.
- Synimi drejt përmirësimit të funksionimit të organizatave sportive kombëtare dhe lokale, federatave dhe klubeve sportive duke përcaktuar marrdhëniet e tyre me shtetin , rritjen e autonomisë së funksionimit, forcimin e demokracisë së brendshme të këtyre organizatave, mbështetje e sportistëve cilësor për rezultate të niveleve të larta , duke i konsideruar si pasuri kombëtare
- Adaptimi dhe zhvillimi i kuadrit ligjor dhe rregulloreve përkatëse për turizmin në përputhje me legjislacionin e ri për turizmin dhe standarteve të OBT-së.
- Përmirësimi i imazhit turistik të Shqipërisë dhe realizimi i marketingut dhe promocionit shqiptar me synim krijimin e identitetit dhe të pozicionimit të saj në tregun ndërkombëtar, si destinacion turistik i interesit të vecantë dhe i një kulture të larmishme.
- Zhvillimi i industrisë turistike, në përputhje me drejtimet strategjike të zhvillimit te turizmit

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij programi konsiston në : Mbështetja dhe Koordinimi i të gjithë strukturave të MTKRS, nëpërmjet planifikimit të Burimeve Njerëzore, Buxhetore dhe të infrastrukturës akomoduese e shërbimeve ndihmëse, për krijimin e të gjitha kushteve në funksion të realizimit të misionit të MTKRS.

3.2 TRASHËGIMIA KULTURORE, MUZETË DHE KULTET

Drejtoria e Trashëgimisë Kulturore, DTK, dhe institucionet kombëtare në varësi të saj mbështetur në strategjinë dhe Programin e Qeverisë, ngarkohen me ligj për ruajtjen, restaurimin, mbrojtjen, manaxhimin dhe katalogimin e trashëgimisë kulturore materiale dhe shpirtërore. DTK koncepton dhe realizon reformën në institucionet kombëtare të trashëgimisë kulturore në bashkëpunim me organizmat ndërkombëtare, integron trashëgiminë kulturore shqiptare si pjesë të kulturës botërore dhe bashkëpunon në luftën kundër trafikut ilegal.

3.3 ARTI DHE KULTURA

Administrimi i institucioneve që kanë nën juridiksion, nëpërmjet mbështetjes dhe financimit, të aktiviteteve artistike dhe kulturore, që zbatojnë politikat integruese dhe bashkëkohore të MTKRS, si dhe mbështetjes së mbrojtjes së pronësisë intelektuale. Orienton dhe koordinon projekte të ideuara në fushën e artit dhe të kulturës nëpërmjet mbështetjes së shoqatave, individëve, shkëmbimit të eksperiencave kulturore, nxitjes së krijimtarisë së lirë. Realizon projekte të përbashkëta në nivel rajonal e më gjerë. Përmirëson infrastrukturën nëpërmjet politikave investuese për rikonstruksione dhe ndërtime të objekteve artistike dhe kulturore, si dhe ngritjen e strukturave institucionale për monitorimin dhe zbatimin e ligjit për të drejtën e autorit.

3.4 ZHVILLIMI I SPORTIT

Harton akte nënligjore duke mbështetur në këtë mënyrë organizatat sportive, për përjashtimin nga detyrimet doganore, sportistët cilësor për rezultate të larta në nivel Europian Botëror dhe Olimpik. Financon projekte sportive dhe mbështet organizatat sportive me fonde për krijimin e kushteve sa më të mira për sportin, për cilësinë sportive, arritjen e rezultateve të larta, kualifikimin profesional. Përmirëson infrastrukturën sportive, jo vetëm nëpërmjet alokimit të fondeve pushtetit vendor për rikonstruksione të objekteve sportive në administrim të këtyre të fundit, por edhe në ndërtime të reja të ambienteve sportive, sipas standarteve përkatëse. Administron objektet që ka në juridiksion, financon ndërtimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve sportive.

3.5 ZHVILLIMI I TURIZMIT

MTKRS, në bashkëpunim me aktorët e tjerë, zbaton strategjinë kombëtare të zhvillimit të turizmit, duke qenë mbështetësja kryesore në planet e veprimit për zbatimin e saj. Mbështet, mbron dhe zhvillon burimet turistike, kulturën dhe trashëgiminë e kombit shqiptar me qëllim përmirësimin e produktit dhe imazhit të Shqipërisë në botë. Rregullon veprimtarinë e bizneseve që operojnë në fushën e turizmit, në përputhje me dispozitat ligjore. Ruan dhe zhvillon trashëgiminë kulturore të Shqipërisë, duke siguruar sukses dhe rritje të shpejtë ekonomike.

3.6 PROGRAME SPECIFIKE KULTURORE

Politika e këtij programi është: Ruajtja e identitetit kombëtar nëpërmjet nxitjes së iniciativës private në fusha të artit dhe kulturës, rinisë dhe mbrojtjes së pronësisë intelektuale.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2008.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

- Ristrukturimi i aparatit të Ministrisë. Kompletimi i Drejtorive të Politikave me specialistë të fushës si dhe specialistë në fushat Juridike dhe Ekonomike, për të mundësuar hartimin e buxheteve të tyre, detajimin dhe ndjekjen operative të zbatimit të buxheteve të institucioneve të varësisë, si dhe ndjekjen e shoqërive anonime me kapital shtetëror.
- Pajisja me programet informatike të nevojshme financiare për evidentimin e pasqyrave financiare të konsoliduara periodike.
- Instalimi i rrjetit të internetit në të gjitha institucionet e varësisë së MTKRS-së, në të cilat mungon kjo lidhje dhe trajnimi i personelit.
- Krijimi institucioneve të reja të vartësisë, si detyrim ligjor.

Produktet që do të ofrohen:

- Organizimi
- Legjislacioni
- Monitorimi

4.2 TRASHËGIMIA KULTURORE, MUZETË DHE KULTET

Objektivat e politikës:

- Vënia në efikasitet e parqeve arkeologjike kombëtare dhe rikonceptimi i strukturave të muzeve kombëtare, në funksion të strategjisë së turizmit kulturor.
- Restaurimi i monumenteve të kategorisë së parë dhe objekteve të kultit.
- Katalogimi dhe krijimi i fondit muzeor kombëtar.

Produktet që do të ofrohen:

- Ruajtja dhe zhvillimi i trashëgimisë kulturore.

4.3 ARTI DHE KULTURA

Objektivat e politikës:

- Zbatimi i ligjit për artin skenik, përmes ngritjes së Qendrës së Artit Skenik dhe të ligjit për librin, përmes ngritjes së Këshillit Kombëtar të librit.
- Mbështetjen financiare të projekteve private, të përbashkëta apo të ideura nga MTKRS, për nxitjen e krijimtarisë së shkrimtarëve dhe artistëve shqiptarë, si dhe krijimi i fondit për të rinjtë, prioritet i MTKRS për angazhimin e të rinjve në jetën kulturore si dhe zbulimin e talenteve të reja.
- Krijimi i fondit për të rinjtë, prioritet i MTKRS për angazhimin e të rinjve në jetën kulturore si dhe zbulimin e talenteve të reja.
- Mbështetje për programe specifike që kanë për qëllim krijimin e një rrjeti kombëtar të shkëmbimit të informacionit në sistemin bibliotekar në vend.
- Inkurajimi i krijuesve shqiptarë nëpërmjet shpalljes dhe vlerësimit në konkurse kombëtare në përputhje me politikat prioritare të MTKRS.
- Përsosja e infrastrukturës së institucioneve të varësisë, me qëllim krijimin e kushteve për një art sa më elitare.

- Forcimi i kapaciteteve administrative për mbrojtjen e pronësive intelektuale përfshirë ngritjen e zyrës së të drejtës së autorit.

Produktet që do të ofrohen:

- Investime në 13 objekte kulturore dhe artistike

4.4 ZHVILLIMI I SPORTIT

Objektivat e politikës:

- Rishikimi i ligjit për sponsorizimin; Studimi i kalimit të klubeve sportive në Sh.A.
- Përsosja e marrëdhënieve financiare në nivelin e organizatave sportive në aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare me synim përfaqësimin e Shqipërisë në Lojrat Olimpike “Pekin 2008”, dhe promovimi i sportit me anën e reklamave apo bizneseve të ndryshme.
- Riorganizimi i sportit në shkollë, si bazë për përcaktimin e sporteve prioritare.
- Studimi i terreneve sportive në 100 % të territorit të Republikës së Shqipërisë përfshirë edhe atyre të shkollave, për të krijuar një ide më të qartë mbi këto terrene, për të vijuar më tej me studime apo plane konkrete rikonstruksioni

Produktet që do të ofrohen:

- Rikonstruksione në 12 objekte sportive
- Pjesëmarrja në aktivitete Kualifikuese për Olimpiadën

4.5 ZHVILLIMI I TURIZMIT

- Promovimi i destinacioneve turistike të Shqipërisë, sipas qarqeve nëpërmjet mbështetjes financiare të strukturave të reja që do të ngrihen në nivel lokal, Zyrat e Shërbimit Turistik.
- Rritja me 15 % e numrit të fushatave promociionale, në krahasim me vitin 2007 dhe shtimi i pjesëmarrjes në më shumë panaire ndërkombëtare të turizmit, dhe që konsiderohen të rëndësishëm për promovimin e destinacioneve turistike, krahasuar me 2 vitet e mëparshëm.
- Përmirësimi dhe vendosja e sistemit të sinjalistikës turistike në të gjithë destinacionet turistike të Shqipërisë.
- Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e turizmit, me synim rregullimin e funksionimit të aktorëve nga sektori publik dhe ai privat në sektorin e turizmit, si dhe zhvillimin e zonave turistike.
- Mbrojtja dhe ruajtja e zonave turistike, si dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve në sektorin e turizmit.

Produktet që do të ofrohen:

- Ngritja e 12 zyrave në qendra turistike të qarqeve të Shqipërisë për ofrimin e informacionit nëpërmjet fletëpalosjeve, hartave dhe materialeve të tjera promociionale, si dhe trajtimi i ankesave të turistëve ndaj sipërmarrjeve turistike.

4.6 PROGRAME SPECIFIKE KULTURORE

Mbështetje e projekteve të fushave art, kulturë e shkruar, rini pronësi intelektuale e trashëgimisë kulturore.

Produktet që do të ofrohen:

- Realizimi i veprimtarive artistike

Tabela Buxheti 2008 sipas programeve dhe llojeve te shpenzimeve, million Lek

Programet	Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqerore 600, 601	Mallra dhe sherbime 602	Subvecionet 603	Te tjera transferte korrente 604, 605	Transferta per buxhetet familiare dhe individet 606	Shpenzime kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	102	45	0	0.500	0	6	153
Trashegimia Kulturore, Muzete dhe Kultet	208	74	0	8	0	305	595
Arti dhe Kultura	407	69	0	35	0	599	1,110
Zhvillimi i Sportit	49	19	0	140	0	60	268
Programe specifike kulturore	0	0	0	143	0	0	143
Zhvillimi i Turizmit	25	67	0	4	0	37	133
Total	791	274	0	331	0	1,007	2,403

5 Plani i Monitorimit i Ministrisë

Identifikoni dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2008.

Treguesit	Njësia	Qellimi
Restaurimi i monumenteve të kultures dhe rehabilitimi i objekteve brenda parqeve arkeologjike në të gjithë territorin e vendit, për të rritur numri e vizitorëve vendas por edhe turistëve të huaj si dhe për të përmirësuar eksperiencën e tyre	Monumente kulture dhe parqe arkeologjike	60 Monumente dhe parqe, kala, objekte kulti, banesa
<ul style="list-style-type: none"> ▪ Fushata promociionale ▪ Pjesëmarrja në panaiet ndërkombëtare të turizmit dhe që konsiderohen të rëndësishëm për promovimin e destinacioneve turistike 	Nr. i fushatave promociionale/Nr i panaiereve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rritje me 15 % në krahasim me vitin 2007 ▪ Pjesëmarrja në dy panaiet në Finlandë dhe Kroaci
Kuadri ligjor në fushën e turizmit, që rregullon funksionimin e aktorëve të sektorit publik dhe atij privat, si dhe zhvillimin e zonave turistike	Nr i ligjeve	Dy ligje të reja për turizmin në Shqipëri, Ligji “Për Turizmin” dhe përgatitja e projektligjit “Për turizmin detar”
Frekuentuesit e aktiviteteve artistike (koncerte, ekspozita, shfaqje teatri etj)	Numër i biletave të shitura nga institucionet e varësisë	80’000 copë
Numri i përdoruesve të shërbimeve të Bibliotekës Kombëtare	Kartat e anëtarësimit	130’000 anëtarë
Pjesëmarrja e delegacionit shqiptar në Lojrat Olimpike “Pekin 2008”	Numri i sportistëve kualifikues	7
Sponsorizime nga subjekte private të veprimtarive sportive të cilëve i ofrohen lehtësi fiskale si dhe kontributi i llotarive sportive në financimin e sportit	Buxheti i sportit	Rritja e këtij buxheti me 10%
Ndërtim dhe rikonstruksioni i ambienteve të rëndësishme sportive kombëtare	Ambiente sportive të ndërtuara/rikonstruktura	1 ndërtim dhe 12 rikonstruktime

Aneks 1 Projekt-ligjet për tu paraqitur

- Projektligji “Për fenë” në Republikën e Shqipërisë.
- Për miratimin e projekt marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë “Për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta”.
- Për miratimin e projekt marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Kryegjyshit Botërore Bektashiane “Për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta”.
- Për miratimin e projekt marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteti Musliman të Shqipërisë “Për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjellta”.
- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin Për kinematografinë”.
- Hartimi i projektligjit të ri “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për artin skenik”.
- Projektvendimi “Për shpërblimin e vlerës artistike në artin skenik dhe për kontributin e angazhimit e përkohshëm në projektet kulturore” (neni 32/1 i këtij ligji).
- Projektvendimi “Për emërimin e Kryetarit të Qendrës Kombëtare të Artit Skenik”.
- Projektvendimi “Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Rinisë”.
- Projektligji i ri për Bibliotekat në R.Sh
- Amendimi i Ligjit Nr. 9616 dt. 27.09.2006, “Për librin në R.Sh.”
- Projektligj “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për Trashëgiminë Kulturore” i ndryshuar.
- Projektvendim “Për Miratimin e Rregullores së administrimit të zonës arkeologjike të Shkodrës’, mbështetur Ligjit ‘Për Trashëgiminë Kulturore’.
- Projektvendim Për Miratimin e Rregullores së administrimit të zonës arkeologjike të Lezhës’ mbështetur Ligjit ‘Për Trashëgiminë Kulturore’.
- Projektvendim “Për Miratimin e Rregullores së administrimit të zonës arkeologjike të Krujës’ mbështetur Ligjit ‘Për trashëgiminë Kulturore’.
- Projektvendim “Për Miratimin e Rregullores së administrimit të zonës arkeologjike të Elbasanit’ mbështetur Ligjit ‘Për trashëgiminë Kulturore’.
- Projektvendim “Për Miratimin e Rregullores së administrimit të zonës arkeologjike të Beratit’ mbështetur Ligjit ‘Për trashëgiminë Kulturore’.
- Projektvendim “Për Miratimin e Rregullores së administrimit të zonës arkeologjike të Vlorës’ mbështetur Ligjit ‘Për trashëgiminë Kulturore’.
- Projektvendim “Për Miratimin e Rregullores së administrimit të zonës arkeologjike të Sarandës’ mbështetur Ligjit ‘Për trashëgiminë Kulturore’.
- Projektligji Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9386, datë 04.05.2005 “ “Për muzetë”.
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin për turizmin”.
- Projektvendimi “Për kushtet dhe kriteret për përfitimin e asistencës financiare për sipërmarrjet dhe projektet turistike”.
- “Për mënyrën e përdorimit të fondit të zhvillimit të turizmit”.
- Projektvendim “Për Kriteret dhe procedurat për zhvillimin e sipërmarrjeve turistike si hotel, fshat turistik, kompleks turistik dhe njësi të tjera akomoduese.

- Projektvendim për miratimin e Marrëveshjes së Pjesëshme të Zgjeruar në Sport (EPAS) të Këshillit të Europës.
- Projektligj për ndryshime në ligjin nr. 8701, datë 1/12/2000 “Për lojrat e fatit, Kazinotë dhe Hipodromet”.
- Projektligj për ndryshime në Ligjin nr. 7892, datë 21/12/1994 “Për sponsorizimet” i ndryshuar.
- Projektvendim “Për një shtesë dhe ndryshim në Vendimin e Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes strukturore dhe shpërblimin e Këshillit Kombëtar të Sportit”.
- Projektvendim për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave “Për kriteret e përcaktimit të nivelit të lartë sportiv dhe mënyrën e shpërblimit të sportistëve, që arrijnë këto nivele” i ndryshuar.
- Projektvendim për disa shtesa dhe ndryshime në VKM Nr. 306, datë 24.5.2006.
- Projektvendim për një ndryshim të VKM nr.667 datë 7/12/2001 “Për mënyrën e financimit të cilësisë sportive”.
- Projektvendim “Për procedurat për transformimin e klubeve sportive në shoqëri anonime”.
- Projektvendim “Për ngritjen e zyrave rajonale të drejtave të autorit”.
- Projektvendim “Për një ndryshim në vendimi nr.343, datë 6.6.2007 për miratimin e tarifave për shërbimet, që ofron Zyra Shqiptare për të drejtat e autorit”.
- Projektligji “Për turizmin detar”.

Aneks 2 Rezultate që lidhen me Integrimin Evropian

- Projekt ligj “Për disa ndryshime në ligjin për bibliotekat”.
- Projekt - vendimi "Miratimi i Strategjisë Kombëtare të Pronësisë Intelektuale", si një nga prioritetet e Partneritetit Evropian 2007 dhe një nga rekomandimet e dala nga takimet e Grupeve të Punës.
- Projektligji "Për disa ndryshime në ligjin 9380, datë 28.04.2005, Për të Drejtat e Autorit dhe të drejta të tjera lidhur me të".
- Përcaktimi i hapësirave dhe specifikimeve të detajuara për lëvizjen e objekteve kulturore në kuptimin e ligjit të bibliotekave.
- Projektligji për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9048 dt. 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore “ është kthyer në ligjin Nr. 9882, datë 28.02.2008.
- Përcaktimi i hapësirave dhe specifikimeve të detajuara për lëvizjen e objekteve kulturore në kuptimin e ligjit Për Trashëgiminë Kulturore.
- Projektligji “për disa ndryshime në ligjin nr. 8096, datë 21/03/1996 “Për Kinematografinë”.
- Përcaktimi i hapësirave dhe specifikimeve të detajuara për lëvizjen e objekteve kulturore në kuptimin e ligjit Për Kinematografinë.
- Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9734 dt. 14.05.2007 ‘Për Turizmin’.
- Zhvillimi i seminareve për trajnimin e nëpunësve të MTKRS-së dhe të Institucioneve të varësisë për të përmbushur detyrimet në zbatim të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së. Këto janë trajnime të organizura në kuadrin e TAIEX për të ndihmuar specialistët e fushave të ndryshme në hartim dhe përafrim legjislacioni. Do të organizohen 3 seminare me tematikat: Përafrim legjislacioni në përputhje me direktivat e BE-së për Trashëgiminë Kulturore”; Impakti rregullator i legjislacioni të BE-së në legjislacionin e Sportit shqiptar”; Zhvillimi i aftësive për thithje fondesh”.
- Identifikimi dhe përthithja e fondeve financiare europiane për mbështetjen e aktiviteteve të ndryshme në fushat: turizëm, kulturë, rini dhe sport.
- Ngritja e strukturave institucionale dhe kapaciteteve në fushën e turizmit.
- Anëtarësimi në programin e Bashkimit Evropian “Europa për Qytetarët”.
- Krijimi i faqes internet të Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit për të pasqyruar veprimtarinë e saj dhe për të qenë transparentë, si dhe për të krijuar akses për publikun me synim lehtësimin e procedurave për ta.
- Zhvillimi i seminareve për trajnimin e nëpunësve të institucioneve të tjera shtetërore, të cilat kanë pjesën e tyre të detyrimeve në zbatimin e ligjit për të drejtat e autorit.
- Lidhja në rrjetet e Zyrës Shqiptare për të Drejtat e Autorit me institucionet homologe të BE-së, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe përmirësimin e nivelit të bashkëpunimit.
- Forcimi i agjencive të administrimit kolektiv të të drejtave të autorit.
- Krijimi i zyrave rajonale të të drejtave të autorit.
- Forcimi i kapaciteteve në gjyqësor që lidhen me të drejtën e pronësisë intelektuale.
- Fushata sensibilizuese mediatike, spote publicitare me synim ndërgjegjësimin e operatorëve dhe të komunitetit, për detyrimet, përgjegjësitë por dhe të drejtat që kanë, në zbatim të ligjit për të drejtat e autorit.
- Ndërgjegjësimi i operatorëve ekonomikë, në të gjitha qarqet e vendit.
- Botimi i publikimeve të ndryshme për të bërë sensibilizimin e kategorive të ndryshme të komunitetit mbi të drejtat dhe detyrimet që kanë në zbatim të ligjit për të drejtat e autorit.

Aneks 3 Investimet publike

Emërtimi i Projektit	Kosto (në milion lekë)
Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	
Blerje paisje	5.0
TVSH - detyrim doganor	1.0
Trashegimia Kulturore, Muzete dhe Kultet	
Blerje paisjesh	21.5
Restaurime banesash	16.5
Restaurime kala	14.5
Restaurime ne qytete antike dhe parqe arkeologjike	36.0
Restaurime te ndryshme	25.0
Resaturime dhe rikonstruksione muzeumesh	41.5
Fond per investime ne objektet e kulteve (monumente kulture)	150.0
Arti dhe Kultura	
Blerje paisjesh	9.7
Monumente dhe buste	7.0
Biblioteka Kombetare - Rikonstruksion	80.0
Biblioteka Kombetare - Blerje paisje	14.1
Biblioteka Kombetare - Studim - Projektim	0.6
Rikonstruksion i Qendres Nderkombetare te Kultures Pjeter Arbnori	380.0
Grant per objektet e kultures	100.0
Rikonstruksione ne godina te artit dhe kultures, te tjera	7.6
Zhvillimi i Sportit	
Blerje paisjesh	1.0
Ndertime te objekteve sportive	39.8
Rikonstruksione te objekteve sportive	19.2
Zhvillimi i Turizmit	
Fondi per zhvillimin e turizmit	21.0
Sinjalistika turistike ne 8 qytete	16.0

Aneks 4 Projekte të ndihmës së huaj

- Rivitalizimi i Qendrave Historike: “Zhvillimi i qëndrueshëm dhe integral i qendrave historike, kulturore, tradicionale”. Ky është një projekt i miratuar nga Komisioni Europian me një buxhet prej 3 Milion Euro, i cili do të lëvrohet nëpërmjet fondeve CARDS 2006 dhe Programit për Zhvillimin e Komunitetit Lokal (LCDP). Ky projekt synon të realizojë një zhvillim të qëndrueshëm integral infrastrukturor, social dhe ekonomik në qendra të banuara, ku ekzistojnë potenciale të trashëguara (arkitekturore, tradite, historie, arkeologjike, etj) të lëna në harresë.
- “Transformimi Kulturor i Shqipërisë: Nga Izolimi tek Pjesëmarrja” Projekt i mbështetur nga Qeveria Spanjolle në bashkëpunim me PNUD dhe UNESCO, në kuadër të programit të Fondit Spanjoll për Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit me një buxhet prej 3 milion \$. Ky projekt synon shfrytëzimin e potencialeve që ka Shqipëria si destinacion turistik dhe kulturor për të nxitur zhvillimin ekonomik të vendit, si dhe inkurajimin e turizmit kulturor me bazë komunitetin si dhe përdorimin e trashëgimisë materiale dhe asaj jo-materiale për të përmirësuar imazhin e Shqipërisë në botë.
- Bashkëpunim me përfaqësinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Shqipëri në kuadrin e programeve në fushën e Rinisë.
- Bashkëpunime në kuadrin e marrëdhënieve dypalëshe Rajoni Puglia - Shqipëri për programe në fushat e kulturës dhe trashëgimisë kulturore.

Aneks 5 Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit

MTKRS do të rrisë vëmendjen dhe pjesëmarrjen e publikut në procesin e denoncimit të korrupsionit ndaj çdo strukture administrative brenda dhe jashtë saj si dhe në institucionet e varësisë. Në këtë drejtim, MTKRS do të marrë masa për:

- forcimin dhe nxitjen e pjesëmarrjes së publikut në denoncimin e rasteve të korrupsionit jo vetëm në sektorin publik por edhe në sektorin privat, në fushat e kulturës, turizmit, rinisë dhe sporteve;
- garantimin e vlefshmërisë së denoncimit të një subjekti, duke i garantuar atij mbrojtje të specializuar në bashkëpunim me struktura të specializuara;
- kanalizimin e energjive, përpjekjeve dhe informacionit nëpërmjet një rrjeti të mirëstrukturuar, efikas dhe operacional që garanton shpejtësi e efikasitet në trajnimin dhe përfshirjen e të gjithë aktorëve përgjegjës.